

K. Lull  
[Handwritten signature]



PROKURORIA E PËRGJITHSHMË  
Nr. 68/4 Prot.  
Datë 24.02.2021  
DREJTORIA [Handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT

Z. Shahu  
[Handwritten signature]  
2M+0 04

Nr. 7/1 Prot./A.M

Burrel, më 22.02.2021

**LËNDA:** Dërgojmë raportin vjetor për vitin 2020, mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.

**DREJTUAR:**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

**TIRANË**

Në përgjigje të shkresës nr.68 datë 14.01.2021 "Për paraqitjen e raportit vjetor 2020", ju dërgojmë raportin vjetor, mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!



**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ABAZ MUÇA**

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT

**RAPORT I PUNËS SË  
PROKURORISË  
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT  
PËR VITIN 2020**

SHKURT, 2021

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

### I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2020

- Lufta kundër korrupsionit
- Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit
- Lufta kundër krimit të organizuar
- Respektimi I të drejtave të njeriut
- Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktimat;
- Bashkëpunimin ndërinstitucional;
- Bashkëpunimin ndërkombëtar;
- Përdorimin e metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive;
- Zbatimi i rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2020”, miratuar datë 18.06.2020 nga Kuvendi i Shqipërisë;
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave “për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” miratuar me vendimin nr.501, datë 24.06.2020;
- Raportim mbi zbatimin e të gjithë Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre;
- Informacion statistikor mbi çështjet penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
- Problematikat e hasura;

### II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË PËR VITIN 2020

- Volumi i punës në hetim;
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë;
- Treguesit kryesorë të punës së Prokurorisë Mat për vitin raportues;
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale;
- Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror;
- Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë;
- Kriminaliteti sipas peshës (numrit më të madh të procedimeve) së veprave penale;
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje).

**I- DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2020**

Viti 2020, për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat ka qenë viti i një angazhimi të gjithanshëm, në funksion të realizimit të detyrave kushtetuese që ka Prokuroria, si organ i ndjekjes penale. Ngarkesa që kemi përballuar këtë vit, treguesit që kemi shënuar në të gjitha drejtimit e ndjekjes penale dhe në përfaqësimin e akuzës në gjykim, flasin për punë me ndjenjë të lartë përgjegjësie, nga të gjithë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe administrata e kësaj prokurorie.

Në këtë raport, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, si organ i ndjekjes penale analizon veprimtarinë e punës së periudhës 1-vjeçare për vitin 2020, gjendjen e kriminalitetit në territorin ku ushtron veprimtarinë e saj, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushtetuese si institucion dhe prokurorëve që përfaqësojnë atë, arritjet, problemet dhe mangësitë e evidentuara, si dhe përcaktimin e prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për rritjen e performancës në veprimtarinë e saj në të ardhmen.

Gjatë vitit 2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat e ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore si Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020.

Sipas urdhërit nr.103, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020”, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka patur angazhim dhe bashkëpunim maksimal për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020, e konkretisht nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri nr.3 datë 23.07.2020 “Për hartimin e planit të masave për zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020” në disa drejtime kryesore:

- Është rritur efikasiteti në ushtrimin e ndjekjes penale.
- Mbi zbatimin e njohurive në funksion të njohjes, zbatimit të legjislacionit penal dhe rritjen profesionale të tyre, prokurorët e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat kanë qenë pjesë e programeve të trajnimit dhe seminareve të zhvilluara, përfshi ato për rritjen e kapaciteteve profesionale në luftën kundër pastrimit të parave e produkteve të veprimraisë kriminale, krimin financiar dhe hetimeve pasurore, për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve/produkteve kriminale.
- Në funksion të zbatimit të ligjit penal, në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas rastit janë bërë analiza për raste dhe çështje të veçanta në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera.
- Mbi kërkesat e autoriteteve të huaja dhe anasjelltas për vitin 2020.
- Mbi rritjen e aksesit të përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore. Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme na është dërguar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.14 datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e së drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve” dhe jo vetëm.

Gjithashtu, mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” miratuar me VKM nr.501 datë 24.06.2020, udhëzimit të

përgjithshëm nr.11 datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë më juridiksion të përgjithshëm” dhe urdhërit nr.112 datë 27.07.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” në këto drejtime:

- **Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit.**
- **Në luftën kundër korrupsionit.**
- **Në luftën kundër krimin të organizuar.**
- **Për forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut.**
- **Për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.**

Si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu siç edhe do të analizohet në vijim të këtij raporti është bazuar në një angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar njëkohësisht urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Siç dhe u përmend më parë, kjo prokurori është angazhuar duke shfrytëzuar kapacitetet profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për të zbatuar me përpikmëri Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” e konkretisht:

Për të përmirësuar më tej performancën në të gjithë treguesit e saj, do të fokusohemi në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritjen e profesionalizmit të prokurorëve, fuqizimin e pavarësisë së institucionit, si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese.

Në mënyrë të përmbledhur, drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit gjatë vitit 2020 mbi zbatimin dhe ecurinë e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, miratuar me VKM nr.501 datë 24.06.2020, udhëzimit të përgjithshëm nr.11 datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë më juridiksion të përgjithshëm” dhe urdhërit nr.112 datë 27.07.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” kanë qenë:

### **1.1. Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit:**

Nga ana e prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka angazhim maksimal në marrjen e masave për respektimin e standardeve etike dhe profesionale, në zbatim të kuadrit të plotësuar ligjor për përgjegjësinë disiplinore, në funksion të forcimit të integritetit, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve, krahas garantimit të pavarësisë së tyre. Në këtë kuadër, pavarësisht se prokuroria jonë, që nga muaji Shtator i vitit 2019 ka funksionuar dhe po funksionon vetëm me një prokuror, i cili njëkohësisht është i komanduar edhe drejtues dhe është i angazhuar maksimalisht në përmbushjen e detyrimeve që përcakton ligji përsa i përket në marrjen e masave për respektimin e standardeve etike e profesionale, në zbatimin e kuadrit ligjor, në rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në punë, madje kjo është e dukshme edhe në arritjen e rezultateve në vitin 2020 e konkretisht:

Janë gjithsej 213 procedime penale të hetuara, nga të cilat 170 të regjistruara, 18 çështje të mbartura nga viti 2019 dhe 25 çështje të rifilluara të pezulluara. Gjithashtu ka vendosur për 101 raste vendim mosfillimi, nga të cilat 82 raste mosfillim procedimi, sipas evidencës statistikore dhe në 19 raste janë vendimmarrje të prokurorit për raste të tjera kur nuk ka element të veprave penale.

#### **Mënyra e përfundimit të hetimit të çështjeve ka qenë e tillë:**

Janë 94 çështje të pushuara, 42 të pezulluara, 8 transferuara dhe 54 çështje të dërguara në gjyq me 76 persona të pandehur, nga të cilët 53 me masë sigurimi personal.

Gjithsej në gjykim janë 81 çështje, së bashku me ato të mbartura në gjykim nga viti 2019 me 119 të pandehur, 69 prej të cilëve me masa sigurimi personal.

Janë gjykuar në vitin 2020 gjithsej 54 çështje më 59 të pandehur, 28 prej të cilëve me masa sigurimi personal, si dhe janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë 16 çështje me 16 të pandehur.

#### **Pjesëmarrja e prokurorit në seancat paraprake ka qenë e tillë:**

Kemi 93 raste ku i janë dërguar kërkesa për pushim çështjeje gjykatës, nga të cilat 61 kërkesa janë miratuar nga ana e saj dhe për 2 raste ka kthyer aktet duke vazhduar hetimin, janë dërguar në gjykatë 5 raste urdhëri penal të pranuar nga gjykata, janë dërguar kërkesa për dërgim çështje në gjyq për 43 çështje<sup>1</sup>.

Siç dhe shihen rezultatet dhe jo vetëm, nga ana e një prokurori të vetëm është përfaqësuar organi i prokurorisë dhe në gjykimin e çështjeve të veçanta penale si lirimet me kusht, ankimimet e personave të dëmtuar nga vepra penale (neni 59 i Kodit të Procedurës Penale), ankimimet e vendimeve të mosfillimit dhe të pushimit etj.

- Në forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak janë marrë masa efektive në hetimin e çështjeve penale në një kohë sa më të shpejtë të mundëshme dhe me efikasitet të lartë, kjo gjë është e dukshme në numrin e personave të dërguar për gjykim, pasi numri i të pandehurve është disa herë më i lartë se numri i çështjeve të dërguara për gjykim e konkretisht janë gjithsej 81 çështje të dërguara për gjykim me 119 të pandehur.
- Gjithashtu, vlen të përmendet dhe roli aktiv i prokurorit në zbulimin dhe kapjen e autorëve të kryerjes së veprave penale nëpërmjet hetimit me metodat speciale të hetimit dhe në dokumentimin e administrimin e plotë të provave. Në disa ngjarje me impakt negativ në shoqëri, sidomos ato të kultivimit të bimëve narkotike, prokurori ka marrë pjesë vetë në vendet e dyshuara për kultivim bimësh narkotike, madje në katër raste është bërë edhe kapja në flagrancë e personave që merreshin me këtë aktivitet të paligjshëm.
- Është rritur roli i prokurorit në drejtimin e policisë gjyqësore dhe në kontrollin e hetimit paraprak, e cila ka sjellë dhe efikasitet në hetim. Kjo është realizuar nëpërmjet kryerjes së veprimeve nga ana e policisë gjyqësore nën drejtimin e prokurorit në vendngjarje apo për

<sup>1</sup> Nëse numri i çështjeve paraprake është më i vogël se i treguesve në statistikën vjetore kjo është për faktin se në gjykatë një numër çështjesh të dërguara nga ana jonë nuk janë të shortuar, pasi janë dërguar në ditët e fundit të vitit, ndaj dhe nuk janë të paraqitura tek çështjet paraprake.

çështje të cilat janë në kuadër të indicieve apo informacioneve të institucioneve të tjera ligjzatuese, për mosrjedhje informacioni. Gjithashtu, këtë vit janë kryer shumë operacione të mirëorganizuar me një plan masash paraprake, gjë që ka sjellë dhe kapjen e disa personave në kushtet e flagrancës, ç'ka ka sjellë edhe efikasitet gjatë hetimit, formulimit të akuzës dhe dërgimin e çështjeve për gjykim.

- Nuk kemi asnjë rast hetimi të filluar kryesisht.
- Sa u citua dhe më sipër, meqenëse kjo prokurori ka funksionuar vetëm me një prokuror, ndaj dhe puna me hetimin, gjykimin është përqëndruar tek një prokuror i vetëm dhe nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje të veçanta nuk është parë e nevojshme, por nga ana e drejtuesit janë nxjerrë e përpiluar urdhëra e udhëzime të ndryshëm për një mirëfunksionim e organizim optimal të punës në prokurori.
- Gjithashtu për ecurinë çështjeve dhe përfundimin e tyre, kryesisht për çështjet prioritare sipas rekomandimeve, ato të pastrimit të parave e produkteve të saj dhe të kultivimit të bimëve narkotike, duke marrë masat e duhura për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të nevojshme që i shërbejnë hetimit. Janë respektuar me përpikmëri afatet proceduriale, si dhe janë respektuar të drejtat e subjekteve të procedimit.
- Në këtë kuadër e në mënyrë të vazhdueshme janë zhvilluar takime, mbledhje me drejtues të policies, të organeve ligjzatuese të tjera, oficerë të policisë gjyqësore ndjekjen dhe hetimin e çështjeve të regjistruara për veprat prioritare të rekomanduara, si ato të pastrimit të parave e produkteve të saj, evazionit fiskal krimin financiar, korrupsionit, kultivimit të bimëve narkotike, duke bërë një analizë të përbashkët e të thelluar të fakteve.
- Çdo dy javë, nga ana e drejtuesit zhvillohen mbledhjet periodike me oficerët e policisë gjyqësore dhe stafin mbi problematikat, njihjen me urdhërat dhe udhëzimet e dala, si dhe prioritare në këto mbledhje është ecuria e hetimit, efikasiteti dhe problematikat e ndeshura në hetim duke i analizuar çështjet që janë në hetim, efikasiteti i cili duket dhe në numrin relativisht të lartë të çështjeve të përfunduar në vitin 2020, pra nga 213 çështje duke parë dhe problematikat që ka rrethi i Matit, ku një ndikim negative ka patur dhe situata e krijuar për shkak të pandemisë, janë përfunduar 198 çështje penale.
- Janë marrë të gjitha masat për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimit dhe ushtrimit të detyrës.
- Prokurori në ushtrimin e funksionit të tij i është vënë në dispozicion e gjithë logjistika e duhur. Gjithashtu, edhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat janë krijuar ambiente të përshtatëshme në zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur në aksesimin dhe në pritjen e publikut.
- Është koordinuar puna me prokuroritë e tjera, kryesisht në marrjen e shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për hetimin e ndonjë çështje konkrete për ato vepra penale që janë sipas prioriteteve të rekomanduara.
- Lidhur me kontributin e dhënë për koordinimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Siç dhe u përmend më parë, kjo ka qenë vetëm në kuadër të mbledhjeve e analizave të përbashkëta me drejtues të këtyre institucioneve dhe nuk ka qenë në kuadër të trajnimeve ndaj në të ardhmen mbetet një prioritet dhe domosdoshmëri trajnimi i prokurorëve dhe i oficerëve të policisë gjyqësore për të rritur aftësimin profesional të tyre, me qëllim dhe

rritjen e cilësisë së hetimit të çështjeve penale, sidomos atyre prioritare të rekomanduara, çështjet e pastrimit të parave, krimeve financiare, hetimet pasurore, korrupsionit, luftën kundër narkotikëve etj.

## 1.2. Në luftën kundër korrupsionit:

Në fokus të veprimtarisë së punës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat ka qenë lufta dhe ndëshkimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, si fenomene të përhapura që kanë qenë pengesë në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Kështu, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat për vitin 2020, nuk ka patur asnjë rast të referuar për veprën penale të korrupsionit sipas nenit 259 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”, po ashtu nuk kemi pasur asnjë rast kallëzimi nga ana e KLSH-së.

Në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.11 datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë më juridiksion të përgjithshëm”, janë marrë një sërë masash për zbatimin e këtyre rekomandimeve e konkretisht:

Në këtë grup veprash penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka të regjistruara vetëm 12 materiale kallëzuese për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nga të cilat 5 raste janë regjistruar procedime penale dhe për të 5-ta rastet është dërguar kërkesa për pushim në gjykatë, si dhe në 7 raste është disponuar me vendim mosfillimi, pasi materiali kallëzues nuk kishte elementë të veprës penale të pretenduar nga kallëzuesi. Materialet kallëzuese të ardhura e të regjistruara janë kryesisht kallëzime penale të bëra nga shtetasit në 11 raste dhe në 1 rast kallëzimi ka ardhur nga ana e Bashkisë Mat. Në asnjë rast procedimi nuk është marrë ndonjë person si i pandehur e për rrjedhojë, nuk kemi asnjë rast të dënuar ndryshe nga një vit më parë, që kishim një të pandehur të dënuar me burg hetuar e gjykuar me masë sigurimi arrest në burg, në hetimin e çështjes ishin përdorur metodat speciale të hetimit. Në këtë vit është disponuar vetëm mbi ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë të dhënë nga gjykata për këtë të dënuar.

Rastet e regjistruara për këtë vepër penale kanë qenë tërësisht në kompetencën tokësore e lëndore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, ndaj dhe nuk kemi patur asnjë rast dërgim për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme.

Kështu, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, për vitin 2020 nuk ka patur asnjë rast të referuar për veprën penale të korrupsionit sipas nenit 259 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”.

Gjithashtu, për vitin 2020 nuk kemi asnjë procedim penal të regjistruar mbi indicie nga KLSH.

## 1.3. Në luftën kundër krimit të organizuar:

Për të përmirësuar më tej performancën në të gjithë treguesit e saj, do të fokusohemi në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritjen e profesionalizmit të prokurorëve, fuqizimin e pavarësisë së institucionit, si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese.



Në mënyrë të përmbledhur, drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit gjatë vitit 2020, mbi zbatimin dhe ecurinë e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, miratuar me VKM nr.501 datë 24.06.2020, udhëzimit të përgjithshëm nr.11 datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë më juridiksion të përgjithshëm” dhe urdhërit nr.112 datë 27.07.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020” kanë qenë:

- Nga ana e Prokurorisë Mat janë marrë të gjitha masat për forcimin e bashkëpunimit me policinë gjyqësore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese me qëllim shkëmbimin e informacionit, për rritjen e efektivitetit të hetimeve për marrjen e masave parandaluese e konkretisht, në rritjen e cilësisë së hetimit për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike. Gjithashtu, është rritur e koordinuar bashkëpunimi edhe me institucione të tjera siç janë Gjykata, Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, Zyra e Përmbartimit Gjyqësor, I EVP etj.
- Për vitin 2020 kemi të regjistruar 4 procedime penale për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Për këto 4 raste është vendosur 1 rast pezullim hetimi, 1 rast është dërguar për gjykim dhe 2 mbarten në hetim.

Gjithashtu, janë të regjistruar në vitin 2020 6 procedime penale dhe 3 procedi penale të mbartuar nga viti 2019, për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Gjatë hetimit të tyre janë përdorur teknikat speciale të hetimit (hetimit proaktiv), nga ku është arritur zbulimi dhe identifikimi i disa prej autorëve, pasi në vitin 2020 numri i personave të marrë si të pandehur është relativisht i lartë në krahasim dhe me vitet e mëparshme, pasi në këtë vit numri i personave të marrë si të pandehur është 17 me 5 persona nën hetim dhe 19 persona me masë sigurimi personal “Arrest me burg”.

Mënyra e përfundimit të çështjeve është e tillë, 3 çështje janë të mbartura në hetim nga viti 2019 dhe 6 çështje janë regjistruar, gjithsej në vitin 2020, pra janë ndjekur dhe hetuar 9 çështje penale me 5 persona nën hetim, me 17 të pandehur. Nga këto, 1 çështje është pushuar me një person nën hetim (I.V) me masë sigurimi “Arrest me burg”, 2 çështje janë pezulluar për moszbulim të autorëve të kryerjes së veprave penale, 4 procedime janë dërguar për gjykim me 17 të pandehur, me 16 persona me masë sigurimi personal “Arrest me burg”; si dhe 2 çështje mbarten në hetim me dy persona nën hetim, me masë sigurimi personal “Arrest me burg”. Mbi rastet kur i është kërkuar gjykatës caktimi i masave të sigurimit personal “Arrest me burg” në mungesë, gjykata ka disponuar me vendim, vendime të cilat janë ekzekutuar nga ana e policisë së shtetit.

Për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal kemi patur dhe 2 procedime penale të rifilluara për shkak të kalimit të afateve të ndjekjes penale/parashkrimit, për të cilat i është dërguar gjykatës kërkesa për pushim procedimi për shkak të kalimit të afateve të ndjekjes penale dhe për këto dy raste, gjykata ka vendosur miratimin e kërkesës së pushimit të procedimit të kërkuar nga prokuroria.

Siç dhe shihet nga të dhënat statistikore, për këtë grup veprash penale është ashpërsuar politika penale në drejtim të masave të sigurimit personal, ku për 9 procedime penale të regjistruara ka 19 masa sigurimi “Arrest me burg”, madje dhe të ekzekutuara, vetëm një rast është në mungesë.

- Numri dhe tendenca e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal dhe masave të dënimit për krimet e rënda. Për vitin 2020 numri i kërkesave për caktim masash sigurimi personal në gjykatë ka qenë për 52 raste, krahasuar me numrin e çështjeve penale të regjistruara ka qenë relativisht optimal, ndërsa lidhur me masat e dënimit për krimet e rënda gjithmonë është marrë në konsideratë rrezikshmëria e veprës penale.
- Gjitashtu, për këtë vit kemi të regjistruar dhe 9 çështje për veprën penale “Pastrim të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe 1 çështje e mbartur në hetim nga viti 2019. Për 7 raste i është kërkuar gjykatës pushimi i procedimit dhe 3 raste janë në hetim.
- Për hetimin pasuror dhe veprat penale të “Pastrimit të produkteve të veprave penale” është krijuar një regjistër i posaçëm, në të cilin janë pasqyruar të gjitha të dhënat e procedimit.
- Nuk kemi asnjë rast hetimi paralel për veprën penale pastrimi i parave apo për vepra penale kryesore që krijon të ardhura, pasuri apo asete nga veprimtari kriminale. Kjo e parë dhe në kuadër të zbatimit pas njohjes edhe me Udhëzimin nr.10 datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokurori”. Për më tepër, nuk kemi patur asnjë rast kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim të asetëve/pasurive produkt i veprimtarisë kriminale.
- Organi i Prokurorisë Mat është njohur dhe ka implementuar Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Prokurorisë së Përgjithshme, me detyrimet specifike të Marrëveshjes me EUROJUST, miratuar me urdhërin nr.140 datë 03.09.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.

#### 1.4. Për forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut:

- Është zbatuar me përpikmëri kuadri ligjor për forcimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Përsa i përket rasteve të zbatimit të instrumenteve të reja penale, siç është urdhëri penal, gjykimi me marrëveshje apo rritja e numrit të rasteve të gjykimit të drejtëpërdrejtë, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat janë zbatuar pjesërisht këto instrumenta, kryesisht është aplikuar në 5 raste urdhëri penal, si dhe gjykimi i drejtëpërdrejtë në 16 raste. Si rezultat i aplikimit të gjykimit të drejtëpërdrejtë në një numër të konsiderueshëm, është përmirësuar efikasiteti në hetimin dhe është ulur norma e kohëzgjatjes mesatare të hetimit të çështjeve. Ndërsa, lidhur me zbatimin e institucionit të gjykimit me marrëveshje nuk është aplikuar në asnjë rast për këtë vit.
- Janë kryer hetime të shpejta dhe janë respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale si në drejtim të të miturve në konflikt me ligjin, të miturve dëshmitarë dhe viktime të veprave penale. Për të gjitha rastet, nga ana jonë, pyetja e të miturve në konflikt me ligjin është bërë në prani të avokatit dhe të psikologut, po kështu është vepruar dhe me të mitur dëshmitarë dhe viktime të veprës penale, që kërkon detyrimisht praninë e koordinatorit.

Mbi aplikimin e dënimeve alternative, në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet me të mitur, ky lloj dënimi është patur në konsideratë gjatë procesit të gjykimit dhe gjykata ka vendosur për një rast me masë këshillimi dhe vazhdimin e studimeve, pasi autori ishte i mitur, në një rast ka aplikuar dënimin me 100

orë pune në interes publik, si dhe në një rast tjetër dënimin me burg në aplikim të neni 59 të Kodit Penal pezullimin e dënimit.

- Në vitin 2020 është regjistruar vetëm 1 rast për veprën penale të “Trafikim i të miturve” të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, procedim i cili ka ardhur për kompetencë.

Nuk kemi patur të regjistruar asnjë procedim penal për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese apo të keqtrajtimit/abuzimit të fëmijëve.

- Janë përmirësuar dukshëm aftësitë profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e çështjeve, që lidhen me drejtësinë penale për të mitur, duke i këshilluar për kryerjen e veprimeve, duke ju vënë në dispozicion për njohjen dhe zbatimin me përpikmëri të Kodit të Drejtësisë për të mitur, hyrë në fuqi me 1 Janar 2018 e Ligjit 37/2017, të strategjisë e drejtësisë dhe planit të veprimit 2020 për këtë kategori.
- Gjithashtu, ju është dhënë prioritet veprave penale të “Dhunës në familje” duke kryer hetime të shpejta dhe ashpërsim të politikës së dënimit dhe në ashpërsimin e kërkesave të masave të sigurimit personal. Në këtë grup veprash penale janë të regjistruar 7 çështje me 8 persona të pandehur, 7 prej të cilëve me masë sigurimi personal “Arrest me burg”. Në 1 rast është pushuar procedimi dhe 6 raste janë dërguar për gjykim me 8 të pandehur, 7 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Nga 6 rastet e dërguara për gjykim, në 2 raste është aplikuar gjykimi i drejtëpërdrejtë, 1 rast gjykimi i zakonshëm dhe 2 raste gjykimi i shkurtuar, për rastet e gjykimit, masa e dënimit ka qenë me burg, ndërsa 1 çështje mbetet në hetim.
- Përsa i përket njohjes me kuadrin ligjor, pjesë e ndryshimeve të Kodit Penal, lidhur me veprat penale në fushën e mjedisit, vlen të theksohet se ndryshimet e fundit të bëra me ligjin Nr.44/2019 janë bërë të njohura për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në këtë prokurori, por nuk kemi patur raste regjistrimi për veprat penale të shtuara me këtë ligj.
- Lidhur me trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve, siç dhe është cituar më parë, mungesa e trajnimeve për oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë është një problematikë e trashëguar që nga vitet e tjera.
- Duke qenë se viti 2019, ka qenë vit zgjedhor dhe nga ky vit kemi një procedim penal të mbartur në gjykim me 15 persona të pandehur, 8 nga të cilët me masë sigurimi personal, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor”, parashikuar nga neni 326/a,1 i Kodit Penal. Ky procedim vazhdon të jetë ende në gjykim.

### 1.5. Për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional:

- Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat janë marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë e të gjithanshëm, në goditjen e grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, kryesisht të grupeve kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimin kundër korrupsionit dhe atij financiar. Janë kryer analiza të përbashkta për procedime të veçanta me policinë e shtetit, për atë grup veprash

- penale që janë në rekomandimet prioritare si ato të trafikimit të lëndëve narkotike, pastrimit të parave, korrupsionit etj.
- Në rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore për hetimin e veprave penale, sidomos në funksion të rritjes së efektivitetit të hetimeve, ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, apo nënpunësve publikë të administratës tatimore. Sipas statistikave, janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të “Fshehje të të ardhurave” të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal dhe 2 procedime penale për veprën penale të “Mospagim i taksave dhe tatimeve” të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, referime të ardhura nga Drejtoria Rajonale e Hetimit Tatimor. Mënyra e përfundimit për këto çështje është me kërkesë për pushim procedimi dërguar gjykatës.
  - Është rritur bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet drejtorive përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim shkëmbimin në kohë reale të informacionit, përmirësimin e cilësisë së hetimit dhe shpejtësisë së kryerjes së veprimeve procedurale, në kuadër të letërporosive nga autoritetet e huaja dhe të komunikimit të akteve, për të cilat janë kthyer përgjigje e dërguar informacione në mënyrën më të shpejtë të mundshme, me anë të email-it apo të shkresave zyrtare kur kërkohet, brenda afateve të të gjitha kërkesave për ekstradim ardhur nga prokuroritë e rretheve apo nga DMJ.
  - Gjithashtu, është kordinuar puna me institucione të tjera lidhur me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të pastrimit të parave etj.
  - Është bërë marrja e masave për rritjen profesionale me qëllim njohjen dhe zbatimin e drejtë të ndryshimeve të legjislacionit penal dhe pjesëmarrja në trajnime të herëpashërshme të prokurorëve, të kryera nga Shkolla e Magjistraturës dhe organizata të ndryshme në funksion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal, në kryerjen e veprimeve hetimore dhe vlerës së provave, veçanërisht në rastet e hetimit të krimit të organizuar, korrupsionit, hetimeve financiare, evazionit fiskal e krimit kibernetik, pastrimit të parave.
  - Numri dhe tendenca e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit pasuror (sekuestro preventive), nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat nuk ka patur asnjë rast kërkesë për caktim mase sigurimi pasuror sekuestro-preventive/konfiskime.
  - Një ndër sfidat prioritare është edhe ruajtja e sekretit të hetimit dhe ndalimi i publikimit të akteve, që për vitin 2020 rezulton të mos kemi patur asnjë rast të nxjerrjes së sekretit të hetimit apo publikim të akteve hetimore.
  - Mbi rritjen e aksesit të përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme na është dërguar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.14 datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e së drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”, për zbatimin e të cilit po bashkëpunohet në vazhdimësi me specialistët e shërbimit të teknologjisë e informacionit, për zbatimin në aksesimin e plotë të tij sipas marrëveshjeve të lidhura me këto institucione, pavarësisht se kemi patur akses edhe më parë si verifikimin e gjendjes gjyqësore dhe në printimin e certifikatave gjyqësore, në aksesimin e databazat e Agjencisë së Prokurimit Publik, Zyrën e Gjendjes Civile, të cilat kanë sjellë dhe rritjen e shpejtësisë së hetimit.
  - Gjithashtu, janë marrë masat në rritjen e efikasitetit në raportimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore, duke rritur profesionalizmin e burimeve njerëzore, duke përdorur sistemin elektronik të teknologjisë së informacionit për nxjerrjen e të dhënave dhe raportimin brenda afateve kohore.

- Janë zbatuar me përpikmëri të gjitha udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm në fuqi, në mënyrë të veçantë udhëzimi nr.5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, ku janë respektuar në mënyrë rigorozë të drejtat e subjekteve të procedimit penal, si të të pandehurve, personave nën hetim, të dyshuarve po ashtu dhe të viktimave të veprave penale të ndryshme.

#### **1.6. Përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimet proaktive:**

Gjatë vitit 2020, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat janë evidentuar dukshëm rastet e përdorimit të teknikave të posaçme të hetimit sipas Kodit të Procedurave Penale siç dhe janë: përgjimet ambjentale, telefonike etj., ndërsa në referim të neneve 294/a dhe 294/b, veprimet stimuluese dhe agjentët e infiltruar, këto veprime pothuajse mungojnë. Në disa çështje janë kryer përgjime të telekomunikimeve dhe në disa prej tyre ka patur rezultate të mira në interes të hetimit, ku për vitin 2020 i është kërkuar gjykatës e dërguar kërkesa për lejim përgjimi, zgjatje afati lejim përgjimi, raste të cilat janë miratuar nga ana e gjykatës dhe përdorimi i tyre ka sjellë efikasitet duke rritur zbulueshmërinë e disa veprave penale, kryesisht ato të “Kultivimit të bimëve narkotike” të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Në të ardhmen mendojmë se do të intensifikohet puna në drejtim të përdorimit të këtyre metodave speciale të hetimit, duke qenë se krimi i organizuar dhe krimi në përgjithësi po avancojnë dhe po bëhet më konspirativ.

#### **1.7. Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre.**

Gjatë vitit 2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat e ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe në respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020.

Sipas urdhërit nr.103, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020”, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka patur angazhim dhe bashkëpunim maksimal për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020 e konkretisht nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhëri nr.3 datë 23.07.2020 “Për hartimin e planit të masave për zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020”, në disa drejtime kryesore:

- Është rritur efikasiteti në ushtrimin e ndjekjes penale
- Mbi zbatimin e njohurive, në funksion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal dhe rritjen profesionale të tyre, prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat kanë qenë pjesë e programeve të trajnimit dhe seminareve të zhvilluara, përfshi ato për rritjen e kapaciteteve profesionale në luftën kundër pastrimit të parave e produkteve të veprimraisë kriminale, krimit financiar dhe hetimeve pasurore, për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve/produkteve kriminale.
- Në funksion të zbatimit të ligjit penal, në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas rastit janë bërë analiza për raste dhe çështje të veçanta në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera.
- Mbi kërkesat e autoriteteve të huaja dhe anasjelltas për vitin 2020.

- Mbi rritjen e aksesit të përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore. Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme na është dërguar Udhëzimi i Përgjithshëm nr.14 datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e së drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve” dhe jo vetëm.

Në mënyrë periodike i është dërguar informacion Prokurorisë së Përgjithshme në kuadër të zbatimit të Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”.

### **1.8. Informacion statistikor mbi çështjet penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.**

Viti 2020 nuk ka qenë vit zgjedhor, ndaj në këtë vit nuk kemi patur asnjë rast regjistrimi procedimi apo materiali kallzues për veprat penale të parashikuara nga Kreu X i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (nenet 325-332/a), por mbartet në gjykim një procedim i vetëm me 15 persona, me 8 të pandehur me masa sigurimi personal, ndërsa për 7 persona, 3 prej të cilëve me masë sigurimi personal, i është kërkuar gjykatës pushimi i hetimeve.

### **1.9. Problematikat e hasura:**

- Një problematikë e evidentuar në raport me policinë, pra shërbimet e policisë gjyqësore janë lëvizjet e shpeshta të oficerëve. Ka raste të zëvendësimit në një procedim penal të oficerëve të policisë gjyqësore, kjo për shkak të lëvizjeve të shpeshta nga një sektor në tjetrin. Gjithashtu, ka raste që dosjet janë sjellë në prokurori pas një muaji nga lëvizjet, pa relacion, materiale procedurale të referuara jashtë afatit 5 ditor në rastet kur nuk ka materiale të sekuestruara dhe jashtë afatit 2 ditor në rastet kur kemi materiale të sekuestruara etj.
- Janë të shpeshta rastet kur nuk respektohet afati i lënë nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore, ku në lidhje me këtë problematikë është kërkuar rritja e kontrollit nga prokurori që delegojnë kryerjen e veprimeve hetimore. Ajo që duhet evidentuar si mangësi është mostrajtimi i rasteve të shkeljeve duke kaluar në procedim disiplinor oficerët e policisë gjyqësore. Gjatë dinamikës së punës në hetimin e çështjeve, shpesh evidentojmë të meta dhe mangësi, që janë trajtuar duke tërhequr vëmendjen.
- Administrimi i akteve të ekspertimit në shumë raste vonon dhe nuk kryhet në kohë, pra administrimi i tyre në dosje sjell vonesa dhe zvarritje në hetim.
- Një problematikë tjetër është dhe mospasja e një infrastrukture të nevojshme për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, mospasja e kësaj infrastrukture shpesh herë na çon në vonesa për kryerjen e veprimeve të duhura procedurale.

## **II- ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT PËR VITIN 2020**

### **2.1. Volumi i punës në hetim për vitin 2020**

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, gjatë vitit 2020 janë trajtuar 268 materiale kallëzuese/referuese që përbën një rënie, në krahasim me vitin 2019 gjatë të cilit janë regjistruar 341 materiale kallëzuese/referuese. Janë ndjekur gjithsej 213 procedime penale nga të cilat 25

të rifilluara, ku ka një ulje të lehtë në krahasim me vitin 2019 me 12 procedime më pak, në të cilin janë ndjekur 225 procedime penale, nga të cilat 31 të rifilluara.

Janë mbartur nga viti 2020 për në vitin 2021, gjithsej 15 procedime, nga 18 procedime penale që ishin mbartur nga viti 2019<sup>2</sup>.

Për 268 materiale kallëzuese është vendosur mosfillimi për 101 referime dhe kallëzime penale të vitit 2020, krahasuar me 150 kallëzime të mosfilluara gjatë vitit 2019.

Volumi i punës në hetim i organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat për vitin 2020 paraqitet si vijon:

Lloji i Procedimeve Penale	Numri i procedimeve	Persona nën hetim	Të pandehur	Të arrestuar
Procedime të mbartura nga 2019	18	3	22	16
Procedime penale të regjistruara	162	15	54	42
Rifilluar të pushuara/	0	0	0	0
Rifilluar të pezulluara	25	0	0	0
Ardhur me transferim	8	0	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>213</b>	<b>18</b>	<b>76</b>	<b>58</b>

Krahasimi i statistikave të dy viteve të fundit

Viti	Kallëzime të regjistruara	Procedime të mbartura	Procedime të regjistruara	Rifilluar/ Transferuar	Ndjekur procedurat në hetim
2019	341	17	172+5=177	31/7	225
2020	268	18	162+8=170	25/8	213

Nga 213 procedime të ndjekura në vitin 2020, u është dhënë zgjidhje 198 procedimeve me 14 persona nën hetim, me 76 të pandehur dhe 55 të arrestuar, si vijon:

- **Pushime:** 94 procedime penale me 13 persona në hetim, me 2 persona me masa sigurimi personal, ku nga 94 çështje të pushuara 25 janë çështje të rifilluara e të pushuara për shkak të kalimit të afateve të ndjekjes penale, krahasuar me 77 procedime penale nga të cilat 31 të pushuara për shkak të kalimit të afateve të ndjekjes penale në vitin 2019.
- **Pezullime:** 42 procedime janë pezulluar, për shkak se pas hetimit të kryer për këto procedime penale nuk është bërë e mundur të identifikohen autorët e veprave penale nga këto procedime, krahasuar me një vit më parë numri i procedimeve të pezulluara ka pësuar një rënie, ku kjo zgjidhje ligjore është vendosur për 16 procedime penale më pak, pasi gjatë vitit 2019 pezullimi i hetimeve është vendosur për 58 procedime penale.

<sup>2</sup> Janë ndjekur gjithsej 213 procedime penale në vitin 2020, nga të cilat 162 regjistruar rishtazi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat, 8 të ardhura nga Prokurori të tjera, 25 të rifilluara, si dhe të mbartura 18 çështje nga viti 2019, pra gjithsej 213.

- **Transferime:** Për 8 procedime penale, me 1 person nën hetim. Për këto raste prokurori ka konstatuar moskompetencën për hetimin e tyre, prandaj dhe ka vendosur transferimin në prokurorinë kompetente.
- **Dërguar në gjyq:** Gjatë vitit 2020, prokuroria ka vendosur dërgimin në gjykatë për 54 procedime, me 76 të pandehur dhe 53 me masa sigurimi personal, kundrejt 65 procedimeve penale të dërguara në gjykatë gjatë vitit 2019, me 82 të pandehur dhe 32 persona me masa sigurimi personal. Në vitin 2020 janë dërguar për gjykim 11 çështje më pak krahasuar me vitin 2019, por pavarësisht numrit më të vogël të procedimeve penale të dërguara në gjykatë, numri i personave të pandehur, që ju është ngritur akuzë ka qenë afërsisht sa në vitin 2019. Në vitin 2020 ju është njoftuar akuza 76 personave, kundrejt 82 personave në vitin 2019.
- **Mbeten në hetim çështje të vitit 2020 në vitin 2021:** 15 procedime, me 4 persona nën hetim, nga të cilët 3 persona me masa sigurimi personal.

#### Janë gjykuar gjatë vitit 2020:

- 54 çështje, me 59 të pandehur, nga të cilët 28 persona me masa sigurimi personal.
- Mbeten në gjykim 27 procedime, me 60 të pandehur, nga të cilët 41 persona me masa sigurimi personal.

## 2.2. Çështje të përfaqësuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Gjatë vitit 2020, nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Mat është ngritur dhe përfaqësuar akuzë në Gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 81 procedime penale, me 119 të pandehur, 69 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Krahasuar me vitin 2019, gjatë të cilit u përfaqësuan në Gjykatë 94 procedime penale, me 114 të pandehur, ku 46 persona me masë sigurimi personal. Rezultojnë 13 procedime me pak se në vitin 2019 dhe 5 të pandehur më shumë se një vit më parë, për rrjedhojë ngarkesa e përfaqësimit në vitin 2020 për prokuror ka qenë më e lartë se një vit më parë, pasi të gjitha çështjet janë përfaqësuar nga një prokuror i vetëm, ndërsa në vitin 2019 deri në muajin Shtator 2019 kanë qenë dy prokurorë.

Janë gjykuar gjithsej gjatë vitit 2020, saktësisht 54 çështje penale me 59 të pandehur, 28 prej të cilëve me masa sigurimi personal. Ndërkohë, gjatë vitit 2019 janë gjykuar 67 çështje penale me 71 të pandehur, 33 prej të cilëve me masa sigurimi personal.

Gjithashtu, janë paraqitur në Gjykatë 52 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal, nga të cilat 42 prej tyre me “Arrest në burg”, 6 me “Arrest në burg në mungesë”, 1 “Arrest në burg me afat”, 3 me “Arrest shtëpie”, ndërsa masa “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” nuk është kërkuar në asnjë rast nga prokurori gjatë vitit 2020. Në rastet kur nga gjykata është vendosur masë sigurimi e ndryshme nga ajo e kërkuar nga prokurori, është bërë ankim.

## 2.3. Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë për vitin 2020

### Procedime penale të regjistruara

Nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2020 janë regjistruar rishtazi 170 procedime penale, krahasuar me 177 çështje të regjistruara në vitin 2019, fakt i cili tregon se gjendja e



kriminalitetit ka pësuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2019. Lloji i veprave penale të regjistruara, pothuajse është i njëjtë me veprat penale të regjistruara në vitin e mëparshëm. Në vitin 2020 është rritur numri i çështjeve të regjistruara për veprën penale të “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

### **Mosfillimet**

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet, për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezultojnë se në vitin 2020 është vendosur mosfillimi për 101 referime dhe kallëzime penale, nga 150 të vitit 2019<sup>3</sup>. Ky tregues shpjegohet ndër të tjera, pasi ka materiale të cilat regjistrohen dhe nuk kanë elementë të veprave penale, siç janë largimet nga banesa, vdekjet aksidentale etj., që në vitin 2020 janë vendosur për 19 raste të tilla me vendim mosfillimi<sup>4</sup>.

### **Pushimet e çështjeve**

Gjatë vitit 2020, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat është vendosur pushimi për 94 procedime penale, nga të cilat 25 të rifilluara, 17 çështje më shumë krahasuar me vitin 2019 gjatë të cilit u vendos pushimi për 77 procedime penale, ku 31 të rifilluara. Në të gjitha këto procedime penale, përgjithësisht janë kryer veprime hetimore të plota dhe në çdo rast është bërë njoftimi i vendimit të pushimit si kallëzimitarëve, institucioneve apo individëve dhe palëve të interesuara.

Duke iu referuar statistikës për grup, veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi rezultojnë se është vendosur pushimi si vijon:

- Për veprat penale kundër jetës së personit, të parashikuara nga nenet 76-133 të Kodit Penal janë pushuar 16 çështje gjatë vitit 2020 dhe peshën kryesore në këtë grup veprash e përbën vepra penale e Vetëvrasjes me 5 raste, Kanosjes me 5 raste, Plagosjes së lehtë me dashje me 4 raste, vrasjes për shkak të marrdhënieve familjare dhe dhunës në familje me nga 1 rast, kundrejt 13 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2019.
- Për veprat penale kundër pasurisë, të parashikuara nga nenet 134-200 të Kodit Penal janë pushuar 47 gjatë vitit 2020, kundrejt 39 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2019. Në këtë grup veprash penale afërsisht gjysma e tyre e përbëjnë çështjet e rifilluara me 23 çështje të pushuara.
- Për veprat penale kundër mjedisit, rendit, sigurisë publike dhe zgjedhjeve të lira, të parashikuara nga nenet 201-332/a të Kodit Penal, janë pushuar 30 çështje kundrejt 25 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2019.

### **Procedimet penale të pezulluara**

Është vendosur pezullimi i hetimeve, në bazë të nenit 326 të Kodit të Procedurave Penale për 42 procedime penale, 16 procedime më pak se në vitin 2019, gjatë të cilit janë pezulluar 58

<sup>3</sup> Sqarojmë se nga të dhënat statistikore rezultojnë gjithsej 82 mosfillime në vitin 2020 dhe 120 në vitin 2019.

<sup>4</sup> 82 raste sipas statistikës+19 raste pa vepra, pra 101 raste.

procedime penale. Evidenca e pezullimeve të procedimeve penale, e ndarë sipas grup-veprave është si vijon:

- Për veprat penale kundër jetës së personit të parashikuara, nga nenet 76-133 të Kodit Penal janë pezulluar 2 procedime penale gjatë vitit 2020, ndërsa në vitin 2019 është pezulluar 1 procedim penal.
- Për veprat penale kundër pasurisë, mjedisit, të parashikuara nga nenet 134-207 të Kodit Penal janë pezulluar 35 procedime penale gjatë vitit 2020, kundrejt 47 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2019.
- Për veprat penale kundër rendit, sigurisë publike dhe zgjedhjeve të lira, të parashikuara në nenet 235/1-332/a të Kodit Penal janë pezulluar 5 procedime penale gjatë vitit 2020, kundrejt 10 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2019.

Siç vihet re, procedimet penale të pezulluara që zënë një peshë të konsiderueshme, janë procedimet e veprave penale kundër pasurisë. Këto procedime janë kryesisht me vendngjarje të referuara nga seksionet e Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Mat dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Në të gjitha rastet është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore, si dhe janë deleguar veprime të posaçme dhe në përfundim, bazuar dhe në relacionin e oficerëve të policisë gjyqësore është vendosur pezullimi i hetimeve.

Për pjesën tjetër të procedimeve është vendosur pezullimi i hetimeve për veprat penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, kultivimit të bimëve narkotike etj. Gjatë vitit 2020 ka patur një trend në rënie numri i procedimeve penale të pezulluara, krahasuar me një vit më parë, tregues ky që flet për zbulueshmërinë e autorëve të kryerjes së veprave penale..

Krimi pa autor shoqërohet me impakt të rëndë shoqëror, ai përcjell mosbesim tek organet e rendit dhe të ndjekjes penale, si dhe pasiguri sociale për jetën dhe pronën. Me këtë vlerësim duhet gjykuar treguesi i pezullimit të hetimeve të vendosura gjatë vitit 2020 me 42 procedime penale të pezulluara.

Rritja e zbulueshmërisë së autorëve të veprave penale kërkon përmirësimin e punës me procedimet penale pa autor. Nga prokurorët kërkohet që të orientojnë më mirë dhe më drejtë hetimin, duke përcaktuar detyra dhe veprime konkrete, ku nga ana e prokurorit këtë vit është rritur numri i çështjeve duke përdorur teknikat speciale të hetimit, gjë që ka sjellë dhe zbulueshmërinë e autorëve të veprave penale në disa raste, por prokurori duhet të ndjekë edhe vetë disa prej veprimeve që kërkojnë njohuri dhe profesionalizëm, si dhe duke aplikuar më shumë hetime proaktive.

Por natyrisht që rritja e zbulueshmërisë kërkon edhe angazhim më të mirë të strukturave të policisë gjyqësore që janë në terren, që të ushqejnë hetimin me të dhëna dhe fakte në vijimësi dhe të mos ngelen vetëm në kuadrin e të dhënave të siguruara nga veprimet e para hetimore.

### **Procedimet penale të transferuara**

Është vendosur transferimi për kompetencë për 8 procedime penale me 1 person nën hetim. Për një rast është bërë konflikt kompetence nga prokuroria pritëse dhe nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është caktuar kompetente prokuroria pritëse. Ndërsa, për rastet e tjera nuk ka patur konflikt kompetence.

**Çështjet penale të dërguara për gjykim për vitin 2020**

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat 54 çështje, me 76 të pandehur, 53 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Krahasuar me vitin 2019, gjatë të cilit u dërguan në Gjykatë 65 procedime penale, me 82 të pandehur, 32 prej të cilëve me masë sigurimi personal, rezultojnë 11 çështje më pak, megjithatë numri i të pandehurve është më i lartë në përpjestim me çështjet.

Duke ju referuar veprave penale për të cilën janë akuzuar dhe dërguar për gjykim të pandehurit, statistikat e detajuara rezultojnë si vijon:

- Për veprat penale të “Vrasjes me dashje”, “Vrasjes me paramendim” dhe vrasjeve të cilësuar, të parashikuara nga nenet 76-22 të Kodit Penal, në vitin 2020 janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 5 persona të pandehur, me masë sigurimi personal, ndërsa për nenet 78/1, 79/dh, 79/ë të Kodit Penal, për vitin 2020 nuk është dërguar asnjë procedim penal për gjykim për këtë kategori veprash penale, krahasuar me vitin 2019, ku në këtë kategori veprash penale nuk ka pasur asnjë rast dërgimi në gjyq.
- Për veprat penale të “Kanosjes”, “Plagosjes së rëndë e plagosjes së lehtë me dashje”, “Përndjekjes”, të parashikuara nga nenet 84 dhe 88, 89, 121/a/1 të Kodit Penal është dërguar në Gjykatë vetëm 1 procedim penal gjatë vitit 2020, me 1 të pandehur, krahasuar me vitin 2019, ku ka pasur 5 procedime penale të dërguara në gjyq për këtë grup veprash penale.
- Për veprën penale të “Heqja e paligjshme e lirisë”, të parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal është dërguar për gjykim vetëm 1 procedim penal, me 3 të pandehur, 2 prej të cilëve me masë sigurimi personal, një nga të pandehurit në këtë rast ka bashkëpunuar me drejtësinë për zbulimin e autorëve të kryerjes së veprës penale, kur në vitin 2019 nuk ka pasur asnjë rast dërgimi në gjyq për këtë vepër penale.
- Për veprën penale të “Dhunës në familje”, të parashikuar nga nenet 130/a,1,2,3 ;130/a,4 të Kodit Penal janë dërguar për gjykim 6 procedime penale, me 8 të pandehur, ku 7 me masë sigurimi personal, nga këto 2 raste me gjykim të drejtëpërdrejtë me 2 të pandehur, kundrejt 7 procedimeve në vitin 2019, pra 1 procedim më pak se në vitin 2019.
- Për veprën penale të “Vjedhjes” të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, në vitin 2020 nuk ka asnjë rast dërgimi në gjyq kundrejt 1 procedimi në vitin 2019.
- Për veprën penale të “Shkatërrimit të pronës” të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal kemi dërguar për gjykim 1 procedim me 1 të pandehur, kundrejt 2 procedimeve në vitin 2019.
- Për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal janë dërguar në Gjykatë 7 procedime penale me 7 persona të pandehur, kundrejt 10 rasteve për vitin 2019.
- Për veprën penale të “Pushtimit të tokës”, të parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal është dërguar në Gjykatë për 1 procedim penal, me 1 person të pandehur, ndërsa në vitin 2019 nuk ka patur asnjë rast.
- Për veprën penale të “Mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal është dërguar në Gjykatë me urdhër penal 1 procedim penal me 1 person të pandehur, aq sa dhe në vitin 2019.

- Për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal nuk kemi pasur asnjë rast të dërguar në Gjykatë .
- Për veprën penale të “Largimit nga vendi i aksidentit”, të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal është dërguar në Gjykatë 1 procedim penale me 1 person të pandehur, ndërsa në vitin 2019 nuk ka patur asnjë rast.
- Për veprën penale të “Vetëgjyqësisë”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal është dërguar në Gjykatë 1 procedim penal me 1 person të pandehur, aq sa në vitin 2019.
- Për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal janë dërguar në Gjykatë 5 procedime penale me 7 persona të pandehur, ku 6 me masë sigurimi personal “ Arrest me burg”, kundrejt 2 procedimeve në vitin 2019.
- Për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal është dërguar në Gjykatë me urdhër penal 1 procedim penal me 1 person të pandehur, ndërsa në vitin 2019 asnjë rast.
- Për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal është dërguar për gjykim 1 procedim penal me 1 të pandehur, 1 me masë sigurimi “ Arrest me burg”, aq sa në vitin 2019.
- Për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 4 procedime penal me 17 të pandehur, 16 me masë sigurimi “Arrest në burg”, kundrejt 1 rasti në vitin 2019 me 1 të pandehur, 1 me masë sigurimi “Arrest në burg”.
- Për veprat penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” e “Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga nenet 290 e 291 të Kodit Penal janë dërguar për gjykim 18 procedime me 18 të pandehur, ku 18 me masë sigurimi personal. Për 14 raste është aplikuar gjykimi i drejtëpërdrejtë për veprën penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ndërsa në vitin 2019 janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë 6 raste, nga 17 gjithsej.
- Për veprën penale të “Futjes ose mbajtjes së sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, të parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 2 persona të pandehur, ndërsa në vitin 2019 ka patur vetëm 1 rast.

Pjesën më e madhe të këtyre veprave penale e përbëjnë veprat penale të Kreut III-të-Veptra penale kundër pasurisë dhe ekonomisë dhe kryesisht peshën më të madhe, megjithëse në rënie të theksuar nga viti i kaluar e përbëjnë vepra penale e vjedhjes, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal me 24 procedime penale të reja të regjistruara nga 38 të regjistruara në vitin 2019 dhe vepra penale e shkatërrimit të pronës më zjarr, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal me 10 procedime penale të regjistruara.

Shqetësuese për komunitetin mbetet natyra e veprës penale të vjedhjes, pasi është vënë re se autori/autorët ka/kanë kryer vjedhje më shumë se një herë në të njëjtin subjekt ose vjedhjet janë kryer në të njëjtën natyrë në subjekte të ndryshme, pra figura e kësaj vepre penale është bërë mjaft e larmishme për nga objekti material apo dhe subjekti. Gjatë vitit 2020, numri i procedimeve penale të pezulluara për moszbulim të autorit të veprës penale, ashtu si dhe në vitet e mëparshme vazhdon të jetë i lartë, pavarësisht rënies në krahasim me vitin e kaluar.

Por, ndërsa vjedhja është krimi me përhapje më të madhe, por me tendencë në rënie, zbulueshmëria e autorëve të kësaj veprë penale është mjaft e ulët. Për këtë veprë, në vitin 2020 rezultoi të ketë nga 1 rast pushim procedimi dhe transferim procedimi, pushuar për shkak se objekti rezultoi i humbur dhe jo vjedhur. Përgjithësisht, procedimet për këtë veprë penale raportohen në prokurori pa autor apo pa dyshime konkrete për autorë të mundshëm. Edhe nga hetimi më pas nuk sigurohen të dhëna për autorët e veprave penale dhe në përfundim të hetimeve, raportohet pezullimi i procedimeve penale për moszbulim të autorëve.

Në mënyrë të përmblodhur treguesit e punës sipas viteve janë si në tabelë:

Viti	Regjistruara / Mbartura / Rifilluar	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Në hetim	
2017	191 + 8 mbartura + 76 Rifilluar	50	47+74 Rifill	74	6	23	178
2018	172 + 23 mbartura + 24 Rifilluar	71	42+24 Rifill	50	15	17	147 +44
2019	177 + 17 mbartura + 31 Rifilluar	65	46+31 Rifill	58	7	18	120 +30
2020	170 + 18 mbartura + 25 Rifilluar	54	69+25 Rifill.	54	8	15	82+ 19

#### 2.4. Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale.

Gjatë vitit 2020, të dhënat në lidhje me njoftimet e veprave penale paraqiten si më poshtë: Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të policisë vendore. Kështu nga 268 kallëzime në total të regjistruara për vitin 2020, peshën më të madhe të referimeve prej 218 (81,34%) e zënë referimet e kryera nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Mat dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Nga këto kallëzime 218, pasqyruar në të dhënat statistikore sipas grup veprave përkatëse, gjithashtu rezultoi se 19 materiale kallëzuese pa kualifikim ligjor janë raportuar për vlerësim, si largime nga banesa, mbytje, vdekje nga infarkti etj., janë referime të Policisë së Shtetit.<sup>5</sup> Më tej janë kryer 24 kallëzime nga shtetasit, kemi 1 rast referim nga nëpunës publikë (kallëzim i Bashkisë Mat), 9

<sup>5</sup> Nga këto kallëzime, 252 pasqyruar në të dhënat statistikore sipas grup veprave përkatëse, 19 janë referuar pa kualifikim ligjor, për vlerësim, si largim nga banesa, mbytje etj. dhe 10 janë bashkuar me procedime apo kallëzime në vitin 2020. 3 materiale janë regjistruar procedime penale në vitin 2021. Gjithsej 252+19 Mosf.pa v.p.+2 materiale kallëzuese të regjistruara në vitin 2021=273, ku këtij numri i heqim 5 raste regjistrim procedimesh me ndarje gjatë vitit 2020, pra 273-5=268. Gjithsej 268 materiale kallëzuese, aq sa janë në regjistrin e regjistrimit të veprave penale për vitin 2020.

referime të kryera nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje dhe Policinë të tjera, si dhe 34 raste mbi ankimin e të dëmtuarve nga vepra penale, nga të cilat 34 kanë ardhur nga policia.

## 2.5. Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror.

Nga ana Prokurorisë është kërkuar caktim mase sigurimi personal ndaj 52 personave, ku për 42 persona është kërkuar masa e sigurisë “Arrest në burg” sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale; për 6 persona “Arrest në burg në mungesë”; për 1 person “Arrest në burg me afat”; për 3 persona “Arrest shtëpie”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale dhe asnjë rast “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” sipas nenit 234 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa “Garancia pasurore” sipas nenit 236 të Kodit të Procedurës Penale nuk është kërkuar për asnjë rast.

Nga ana e Gjykatës është vendosur për 52 persona masë sigurimi personal, nga të cilët për 35 persona masa e sigurimit “Arrest në burg”; për 6 persona “Arrest në burg në mungesë”; për 2 persona “Arrest me afat”; për 5 persona “Arrest në shtëpi”; si dhe për 4 persona masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” dhe asnjë rast për “Garanci pasurore”.

Tabela dhe grafiku vijues paraqesin në mënyrë të përmblodhur të dhënat:

Lloji i masës:	Arrest në burg	Arrest në shtëpi	Arrest në burg me afat	Në mungesë / garanci	Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore	TOTALI
<b>Prokurori</b>	42	3	1	6	0	52
<b>Gjykata</b>	35	5	2	6	4	52

## 2.6. Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në vitin 2020 janë nxjerrë urdhëra për ekzekutim për 55 vendime penale të formës së prerë, sipas të dhënave statistikore. Nga këto:

- 32 vendime kanë patur disponim me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim.
- 4 vendime kanë patur disponim me dënim me gjobë.
- 11 vendime kanë patur disponim me dënim me burgim.
- 1 vendim ka patur disponim dënim me burgim të përjetshëm.
- 3 vendime kanë patur disponim për lirim para kohe me kusht.
- 4 vendime kanë patur disponim për pezullimin e ekzekutimit me burgim e detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik.

### Gjithashtu janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi për <sup>6</sup>:

- 8 vendime kanë patur disponim rivlerësim e caktim mase mjekësore.
- 35 vendime kanë patur disponim për shpenzimet proceduriale.

<sup>6</sup> Urdhëra të cilët nuk janë pasqyruar në statistikë.

- 17 vendime kanë patur disponim për kthim prove materiale.
- 2 vendime kanë patur disponim parashkrim ekzekutim vendimi penal të formës së prerë.
- 1 vendim ka patur disponim të mitur në konflikt me ligjin për të cilin është aplikuar shmangia nga dënimi penal.

Viti	URDHËRA EKZEKUTIMI						
	Burg+B.përjet.	Gjobë	Neni 59	Neni 63+64	Rivlesim mase mjekësore	Shpenzime proceduriale	Prova Materiale / të tjera
2020	11+1	4	32	4+3	8	35	17+3
<b>Totali</b>	<b>55</b>				<b>63</b>		

Në vitin 2020 janë ekzekutuar 64 vendime penale, si më poshtë:

- 40 vendime kanë patur disponim me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim.
- 9 vendime kanë patur disponim me dënim me gjobë.
- 8 vendime kanë patur disponim me dënim me burgim.
- 6 vendime disponim dënim alternativ, punë në interes publik.
- 1 vendim disponim lirim para kohe me kusht .

Viti	VENDIME TË EKZEKUTUARA						
	Burg	Gjobë	Neni 59	Neni 63+64	Rivlerism mase mjekësore	Shpenzime proceduriale	Prova Materiale/të tjera
2020	8	9	40	6+1	8	35	17+3
<b>TOTALI</b>	<b>64</b>				<b>63</b>		

## 2.7. Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njërive administrative në kompetencë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat.

Sa i përket shtrirjes territoriale, kriminaliteti ka patur tendencë të shtrirjes në njësitë administrative të Bashkisë Mat dhe Bashkisë Klos, bazuar në materialet e referuara nga Komisariati i Policisë Mat. Kjo vjen si rezultat i gjendjes social-ekonomike të banorëve të kësaj njësie, papunësisë së lartë, prurjeve të reja demografike nga zonat rurale, të cilat janë zhvendosur në qytet për kushte më të mira jetese. Prurjet e reja kanë sjellë së bashku me problemet ekonomike e sociale dhe tendencën në rritje të treguesve të kriminalitetit drejt zonës ku dhe ata banojnë.

## 2.8. Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre

Në lidhje me tendencën e kriminalitetit, të përhapjes së veprave penale në përgjithësi apo me grup veprash penale të veçanta rezultojnë se veprat penale me një shtrirje dhe përhapje më të madhe janë ato kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike me 68/81 procedime penale.

Evidentojmë se për nenet 134/1/2-142 të Kodit Penal janë regjistruar 25 procedime penale kundrejt 40 procedimeve në vitin 2019, ku vlen të theksohet se ka një rënie të theksuar të

kriminalitetit, e cila mund të ketë ardhur dhe për shkak të situatës së krijuar nga pandemia si dhe masat kufizuese gjatë muajve Mars-Prill 2020. Në këtë grup veprash kemi patur vetëm 1 rast sporadik të “Vjedhjes me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal; për nenet 143-149 të Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale, kundrejt 3 të regjistruara në vitin 2019; për nenet 150-162 të Kodit Penal janë regjistruar 17 procedime penale kundrejt 13 të regjistruara në vitin 2019, por në këtë grup veprash shihet një tendencë në rritje e veprës penale “Shkatërrim prone me zjarr” të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal, regjistruar 10 raste; për nenet 163-170 të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim për veprën penale “Shpërdorim kompetence”; për nenet 180-182/a të Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale, ndërsa në vitin 2019 ka patur vetëm 1 rast procedimi; për nenet 186-196 të Kodit Penal janë regjistruar 10 procedime penale, kundrejt 5 të regjistruara në vitin 2019; për nenet 197-198 të Kodit Penal janë regjistruar 3 procedime penale, kundrejt 1 procedimi të regjistruar në vitin 2019 dhe për nenet 199-200 të Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale, kundrejt 15 procedimeve të regjistruara në vitin 2019.

Ndërsa, për veprat penale kundër mjedisit, për nenet 201-207 janë regjistruar 4 procedime penale dhe 1 procedim i ardhur me transferim, gjithsej 5 procedime penale kundrejt 7 rasteve në vitin 2019.

Pas këtij evidentimi duhen përmendur veprat penale që kanë të bëjnë me krime kundër autoritetit të shtetit, veprat penale kundër drejtësisë dhe ato që prekin zgjedhjet e lira, respektivisht 66 procedime të regjistruara dhe 1 i ardhur me transferim, gjithsej 70 procedime penale të detajuara si vijon: për nenet 235-247 të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, aq sa në vitin 2019; për nenet 248-260 të Kodit Penal janë regjistruar 5 procedime penale, kundrejt 7 regjistruara në vitin 2019; për nenet 261-293/c, 294-299 të Kodit Penal janë regjistruar 55+4 të ardhura me transferim, gjithsej 59 procedime penale, kundrejt 48 të regjistruara në vitin 2019 dhe për nenet 300-324/a të Kodit Penal janë regjistruar 5 procedime penale kundrejt 4 të regjistruara në vitin 2019.

Për nenet 325-332/a të Kodit Penal nuk është regjistruar asnjë procedim penal kundrejt 1 procedimi në vitin 2019.

Sa u përket veprave penale të drejtuara kundër shëndetit dhe jetës së personit, rezulton se për vitin 2020 janë regjistruar 24+3 ardhur me transferim, gjithsej 27 procedime, aq sa në vitin 2019 e konkretisht të ndara sipas grup veprave.

Për nenet 76-84/a të Kodit Penal janë regjistruar 8 procedime penale+2 ardhur me transferim, gjithsej 10 procedime, kundrejt 7 të regjistruara në vitin 2019; për nenet 86-90 të Kodit Penal janë regjistruar 5 procedime penale, kundrejt 4 të regjistruara në vitin 2019; për nenet 93-99 të Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale, kundrejt 6 procedimeve të regjistruara në vitin 2019; për nenet 109-112 të Kodit Penal nuk është regjistruar asnjë procedim penal, kundrejt 1 procedimi penal në vitin 2019; për nenet 113-123 nuk është regjistruar asnjë procedim penal, kundrejt 1 procedimi penal në vitin 2019; për nenet 127-130/a/4 të Kodit Penal janë regjistruar 7+1 procedime, po aq sa në vitin 2019 me 8 procedime.

Duke ju referuar të dhënave të lartpërmendura, vihet re se vepra penale e “Vjedhjes” e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, siç është përmendur dhe më parë zë numrin më të madh



të çështjeve të regjistruara në vitin 2020, por krahasuar me një vit më parë ka një rënie të theksuar të numrit të çështjeve të regjistruara për këtë vepër, pra vetëm 24 raste, rreth 14.1% të procedimeve. Ndërsa, përsa i përket zbulueshmërisë së autorëve të kryerjes së veprës penale është shumë e ulët, në asnjë rast të zbuluar, ku përsëri vepra penale e vjedhjes mbetet një fenomen mjaft problematik për rrethin e Matit dhe që duhet të jetë në vijim në fokus të profesionistëve të kriminalistikës.

Evidentohet një tendencë në rritje e çështjeve penale të regjistruara për nenin 290 të Kodit Penal (aksidenteve automobilistike), ku për vitin 2020 zënë 5.88% të numrit të çështjeve të regjistruara, pra janë regjistruar 10 raste kundrejt 3 procedime penale të regjistruara gjatë vitit 2019 ose 1,69%.

Përsëri mbetet problematike, megjithëse viti 2020 shënon një rënie të lehtë të çështjeve penale që lidhen me “Drejtimin e automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në vitin 2019 janë regjistruar 14 çështje, rreth 8,23% kundrejt 16 të regjistruara në vitin 2019.

Rezulton se për nenin 199/a të Kodit Penal që parashikon veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, në vitin 2020 ka shënuar ulje të theksuar regjistrimi i procedimeve penale për këtë vepër, pasi janë regjistruar gjithsej 3 procedime kundrejt 15 procedimeve të regjistruara në vitin 2019.

Gjithashtu, problematikë në vitin 2020, si dhe një vit më parë kanë qenë veprat penale të drejtuara kundër autoritetit të shtetit, grupi i veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike e konkretisht veprat penale të “Prodhim dhe shitje narkotikësh” dhe “Kultivimit të bimëve narkotike”, të parashikuara nga nenet 283 dhe 284 të Kodit Penal, që në vitin 2020 shënon 10 procedime penale ose 5,88%, kundrejt 7 procedimeve të regjistruara në vitin 2019.

Një trend në rënie ka patur dhe vepra penale e “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve....”, e parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, pasi në këtë vit janë regjistruar 6 procedime penale, kundrejt 9 procedimeve të regjistruara në vitin 2019.

Gjithashtu, në vitin 2020 ka patur një rënie të numrit të procedimeve përsa i përket veprës penale të “Shkaktimit të vetëvrasjes” të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal, ku në vitin 2020 janë regjistruar vetëm 4 procedime penale, kundrejt 6 rasteve në vitin 2019.

Grup veprat penale të vrasjes në vitin 2020 kanë patur një rritje kundrejt vitit 2019, në të cilin ka qenë regjistruar vetëm 1 procedim penal, ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar 3 procedime penale dhe 2 të ardhura me transferim, gjithsej 5 procedime penale.

### III- ANALIZA KRAHASIMORE 2 VJEÇARE E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL.

**3.1.** Në vitin 2020 janë regjistruar rishtazi në regjistrin e njoftimit të veprave penale, gjithsej 170 procedime penale, me 15 persona nën hetim dhe 54 të pandehur, nga të cilët 42 me masë sigurimi.

**3.2.** Në vitin 2019 janë regjistruar rishtazi në regjistrin e njoftimit të veprave penale, gjithsej 177 procedime penale, me 47 persona nën hetim dhe 75 të pandehur, nga të cilët 43 me masë sigurimi.

**3.3.** Gjatë vitit 2020 janë hetuar gjithsej 205 procedime penale me 18 persona nën hetim dhe 76 persona të marrë si të pandehur, nga të cilët 58 me masë sigurimi personal. Këtu përfshihen procedimet e mbartura, të rifilluara dhe të ardhura me transferim.

**3.4.** Gjatë vitit 2019 janë hetuar gjithsej 220 procedime penale me 50 persona nën hetim dhe 81 persona të marrë si të pandehur, nga të cilët 48 me masë sigurimi personal. Këtu përfshihen procedimet e mbartura, të rifilluara dhe të ardhura me transferim.

**3.5.** Për vitin 2020 janë dërguar për gjykim 54 çështje me 76 të pandehur, nga të cilët 53 me masë sigurimi; në krahasim me një vit më parë numri i çështjeve të dërguara në gjyq ka qenë më pak, por numri i personave për të cilët është ngritur akuzë dhe marrë si të pandehur pothuajse është i njëjtë me atë të një viti më parë.

**3.6.** Për vitin 2019 janë dërguar për gjykim 65 çështje me 82 të pandehur, nga të cilët 32 me masë sigurimi; si dhe krahasuar me një vit më parë, numri i çështjeve të dërguara në gjyq ka qenë më pak, por numri i personave për të cilët është ngritur akuzë dhe marrë si të pandehur pothuajse është i njëjtë me atë të një viti më parë.

#### IV- ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË MAT PËR VITIN 2020

##### 4.1. Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve.

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat 54 çështje, me 76 të pandehur, nga të cilët 53 me masë sigurimi personal.

Gjatë vitit 2020, pas dërgimit të procedimeve penale për gjykim (përfshirë këtu edhe dosjet e mbartura në gjykim nga viti 2019) ka përfunduar gjykimi gjatë vitit 2020 për 54 procedime penale, me 59 të pandehur nga të cilët, 28 me masë sigurimi personal. Janë mbartur për gjykim 27 procedime penale me 60 të pandehur, 41 prej të cilëve me masë sigurimi personal.

##### 4.2. Të dhëna për gjykimet e posaçme

Gjatë vitit 2020, nga 54 çështje, me 59 të pandehur është zhvilluar gjykimi i zakonshëm për 12 procedime me 14 të pandehur; gjykimi i shkurtuar për 25 procedime, me 28 të pandehur; gjykimi i drejtpërdrejtë për 16 procedime, me 16 të pandehur dhe gjykimi në mungesë, për 1 procedim me 1 të pandehur. Gjykata ka disponuar pothuajse në të njëjtën mënyrë.

Viti	Gjykim i drejtpërdrejtë		Gjykim i zakonshëm		Gjykim i shkurtuar		Gjykim në mungesë		Shuma	
	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur
2020	16	16	12	14	25	28	1	1	54	59

Për sa sipër, prokurori Abaz Muça, për periudhën raportuese veç sa sipër, ka mbuluar edhe detyrën e prokurorit të ekzekutimeve të vendimeve penale gjyqësore, si dhe ka përfaqësuar

organin e akuzës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat në gjykimin e kërkesave të të dënuarve pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel, për lirim me kusht sipas nenit 64 e 59 të Kodit Penal e konkretisht:

- Pjesëmarrja në gjykim për lirim me kusht në 23 raste, 19 prej të cilave të përfunduara, duke u vendosur për 3 raste pranimi i kërkesave të të dënuarve për lirim me kusht, nga ana e Gjykatës Mat dhe nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- Pjesëmarrja në gjykim e çështjeve të veçanta penale si përlllogaritje burgimi ka qenë në 4 raste, përftim nga L.A në 3 raste, kërkesa për mbikqyrje të veçantë në 3 raste, bashkime dënimesh në 5 raste, kërkesa për lejim përgjimi, zgjatje afati lejim përgjimi janë 48 kërkesa të bëra nga prokurori, deklarim ikjeje 8 kërkesa, qëndrim në shtëpi në 1 rast, ankim kundra vendimeve të prokurorit ka marrë pjesë në 9 raste, revokime vendim pezullimi në 6 raste, caktim mase mjekësore dhe rivlerësim mase mjekësore në 3 raste.

### 4.3. Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve

Sic u relatua më sipër, për vitin 2020, sipas të dhënave statistikore ka përfunduar gjykimi në gjykatë për 54 çështje, me 59 të pandehur. Në varësi të llojit të veprave penale, sanksioneve përkatëse, rrezikshmërisë së tyre dhe të pandehurve, shkallës së fajit dhe rrethanave lehtësuese e rënduese janë bërë dhe kërkimet e prokurorit për llojin dhe masat e dënimit.

Nga prokurori është kërkuar deklarimi fajtor për 59 të pandehur, dënim me burgim për 59 të pandehur, nga të cilët 2 të pandehur në kufijtë pranë minimumit të dënimit, 13 të pandehur në kufijtë mesatar të dënimit, për 1 pandehur në kufirin maksimal të dënimit dhe asnjë rast me paraburgim, ndërsa për 35 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, referuar nenit 59 të Kodit Penal.

Dënimi me gjobë është kërkuar për 8 të pandehur, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 145, 200, 242, 273, 274, 277 dhe 280 të Kodit Penal.

Pushimi i çështjes është kërkuar vetëm në 1 rast dhe gjykata ka vendosur për 1 rast<sup>7</sup>.

Nga ana e gjykatës, në lidhje me kërkesat e bëra nga prokuroria, që parashtruan më sipër është vendosur deklarimi fajtor për 57 të pandehur, nga 59 të kërkuar nga prokuroria.

Nga gjykata është vendosur: Dënimi me burgim për 51 të pandehur nga të cilët 6 të pandehur në kufijtë e minimumit të dënimit, 1 të pandehur me paraburgim, për 7 të pandehur në kufijtë e dënimit mesatar, asnjë në kufijtë maksimalë të dënimit dhe për 35 të pandehur ka aplikuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, referuar nenit 59 të Kodit Penal.

Dënimi me gjobë është dhënë nga gjykata për 6 të pandehur.

Gjatë vitit 2020, gjykata ka deklaruar 2 raste të pafajshëm për veprën penale të “Vrasjes me paramendim” mbetur në tentativë, të parashikuara nga neni 78-22 i Kodit Penal. Nga ana e prokurorit është bërë ankim dhe çështja është në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

<sup>7</sup> Çështje paraprake Riza Huta.

Krahasuar me vitin 2019, numri i çështjeve të gjykuara në vitin 2020 është më i ulët, me 13 çështje më pak.

VITI	SHUMA	
	ÇËSHTJE	TË PANDEHUR
2019	67	71
2020	54	59

**4.4. Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si: gjinia, moshja, arsimit, punësimi, etj.**

Nga të dhënat statistikore, rezulton se numri i personave të mitur që kryejnë vepra penale nuk është shumë i lartë. Kështu, rezulton se në vitin 2020 është regjistruar vetëm 1 çështje penale me autor të veprave penale 1 person të mitur, për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, hetuar në gjendje të lirë, pa masë sigurimi personal.

Nga viti 2019, janë të mbartura 3 çështje në gjykim me 3 persona të mitur, të cilat janë gjykuar në vitin 2020.

Si zakonisht, në më të shumtën e rasteve të evidentuara, veprat penale kryhen nga të rriturit dhe në të shumtën e rasteve nga meshkujt. Nga 52 persona të rritur, autorë të veprave penale, vetëm 3 prej tyre janë femra.

Në përgjithësi ka një raport jo të drejtë në nivelin e arsimit të personave autorë të veprave penale. Kështu evidentohet se 31 persona janë me arsim 9-vjeçar, 23 të tjerë janë me arsim të mesëm dhe 2 me arsim të lartë. Rezulton se 40 prej tyre janë të papunë, vetëm 1 rast i punësuar në shtet dhe 10 të punësuar në sektorin privat. Pra, siç dhe shihet, vetëm një pjesë e vogël janë të punësuar apo të vetëpunësuar.

Evidentohet se shumica e personave që kryejnë vepra penale banojnë në zonat rurale dhe pjesa tjetër në qytet. Kështu sipas statistikave, 40 autorë të veprave penale banojnë në fshat dhe 16 banojnë në qytet.

**4.5. Të dhëna për të pandehurit e mitur (numri i procedimeve të regjistruara).**

Gjatë vitit 2020 është regjistruar vetëm 1 çështje penale me autor të veprave penale 1 person të mitur, për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal, hetuar në gjendje të lirë, pa masë sigurimi personal.

Ndërsa, nga viti 2019 mbartet në gjykim çështje penale me 3 të mitur në konflikt me ligjin. Gjykata për këto raste ka vendosur në 1 rast me shmangie nga dënimi, me këshillim, 1 rast me punë në interes publik dhe 1 rast dënimin me burg në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal.

**4.6. Të dhëna për pasojat e veprave penale**

Sa u përket të dhënave lidhur me pasojat e veprave penale, sipas statistikave rezulton se për vitin 2020 ka patur nga 2 raste me vdekje dhe të plagosjes së rëndë. Janë regjistruar 3 raste

plagosje e lehtë. Ndërsa, 2 raste vdekjeje personi kanë qenë si pasojë e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290 i Kdoit Penal.

Gjithashtu, në vitin 2020 janë shënuar edhe 4 raste vdekjeje, “Shkaktim vetëvrasjeje”, e parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal.

**V- TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA.**

**5.1. Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë), njohje vendimi, transferim procedimi, ekzekutim letër porosie, etj.**

Nga të dhënat e verifikuara, rezulton se gjatë vitit 2020 nuk është kryer asnjë procedurë ekstradimi për jashtë shtetit apo nga jashtë të personave të pandehur. Ka patur disa raste sporadike të letër porosive nga jashtë shtetit, në përgjithësi për njoftim të akteve të personave të dënuar. Gjithashtu, nuk ka patur asnjë kërkesë për njohje të vendimeve të huaja penale.

**VI- TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE**

**6.1. Ngarkesa specifike e punës për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat gjatë gjithë vitit 2020 ka funksionuar me një prokuror dhe dy oficerë të policisë gjyqësore. Me këtë kapacitet, mendojmë se janë përmbushur më së miri detyrimet ligjore të organit të akuzës së Matit, duke marrë në konsideratë ngarkesën e secilit.

Kjo ngarkesë pune paraqitet si më poshtë:

- Prokuori Abaz Muça ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 170 procedime penale të regjistruara, 18 të mbartura nga viti 2019 dhe 25 të rifilluara, pra në total 213, në krahasim me 176 procedime në vitin 2019. Ka dërguar për gjykim 54 procedime, nga 48 të një viti më parë; ka vendosur pushimin për 94 procedime, nga 60 procedime të një viti më parë, 25 prej të cilave të rifilluara, 8 procedime të transferuara; ka pezulluar hetimet për 42 procedime dhe 15 procedim mbeten në hetim.
- Gjithashtu, prokurori Abaz Muça ka vendosur mbi mosfillimin e procedimit për 101 raste.
- Tabela në vijim pasqyron ngarkesën e prokurorëve me ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim gjatë vitit 2020.

Prokurori	Hetime totale	Të përfunduara	Gjykim	Pezullim	Pushim	Transferim	Mbartur
<b>A.Muça</b>	188+25Rif.=213	198	54	42	69+25=94	8	15
<b>TOTALI</b>	<b>188+25Rif.=213</b>	<b>198</b>	<b>54</b>	<b>42</b>	<b>69+25=94</b>	<b>8</b>	<b>15</b>

Hetimi për vitin 2020 është mbuluar nga oficerët e policisë gjyqësore të prokurorisë dhe nga oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Mat e të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Përgjithësisht, delegimi i procedimeve penale është bërë sipas sugjerimit që kanë bërë Komisarati i Policisë Mat dhe Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, duke u deleguar procedimet oficerëve që kanë referuar materialin dhe kanë kryer veprimet kryesore proceduriale dhe

hetimore. Në disa raste, sugjerimi për delegim është bërë për oficerët e policisë gjyqësore të komisariatit, që mbulojnë zonën ku ka ndodhur vepra penale.

Oficerët e Policisë Gjyqësore të strukturës pranë prokurorisë Artan Ballabani, Isak Hoxha për vitin 2020 kanë përballuar ngarkesë të konsiderueshme materialesh dhe procedimesh penale, duke e llogaritur peshën në përqindje janë hetuar 40.58% të çështjeve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë. Përgjithësisht, Oficerët e Policisë Gjyqësore të strukturës pranë Prokurorisë kanë kryer veprimet verifikuese për shumicën e materialeve në fazën verifikuese, si dhe kanë ndjekur në hetim procedimet penale të regjistruara mbi kallëzimet e qytetarëve dhe procedime të tjera të referuara nga policia.

Por, gjatë vitit 2019, Oficerët e Policisë Gjyqësore të strukturës së Prokurorisë, krahas me hetimin janë ngarkuar edhe me detyra të tjera, sipas nevojave që ka diktuar puna në sektorë të ndryshëm të Prokurorisë, psh.: me mbajtjen e regjistrit të ekzekutimeve dhe në ndjekjen e ekzekutimeve të vendimeve penale, mbajtjen e dosjeve dhe ekzekutimeve penale.

Puna e Policisë Gjyqësore e strukturës pranë Prokurorisë dhe e atyre pranë Komisarariatit të Policisë Mat dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe polici të tjera, vlerësohet pozitivisht, jo vetëm për dokumentimin e mirë të veprave penale, por edhe për hetimin me shpejtësi e pa zvarritje të procedimeve penale.

Tabela më poshtë pasqyron ngarkesën e Oficerët e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë për vitin 2020.

O.P.GJ	Hetuar	Pezullim	Pushim	Transferim	Gjykim	Hetim
<b>I.Hoxha</b>	33+2 mbartura=35	7	18	1	8	1
<b>A.Ballabani</b>	35+2 mbartura=37	3	24	7	3	0
<b>Totali</b>	<b>72</b>	<b>10</b>	<b>42</b>	<b>8</b>	<b>11</b>	<b>1</b>

### Kërkesat paraprake

Vlen të përmendim dhe ndryshimet e fundit të ligjit penal, të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat e ka zbatuar me përpikmëri për sa vijon:

- Dërguar Gjykatës për pushim çështje ose akuze 93 procedime me 10 persona nën hetim, ku gjykata në 61 ka pranuar pushimin e procedimit dhe në 2 raste ka kthyer aktet.
- Dërguar Gjykatës për miratim urdhëri penal 5 çështje me 5 të pandehur, ku nga ana e gjykatës janë miratuar të 5 rastet.
- Në vitin 2020 nuk kemi patur asnjë rast dërguar Gjykatës për miratim marrëveshjeje.
- Dërguar në seancë paraprake kërkesa për gjykim 43 çështje me 78 të pandehur, ku nga ana e Gjykatës është miratuar kërkesa për dërgim në gjyq për 38 çështje, 2 raste pushuar akuza dhe mbarten 5 raste për vitin 2021.

### 6.2. Ushtrimi i rolit dhe kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë.

Drejtuesi i prokurorisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe organizimin e punës në prokurori dhe jo vetëm, si ndjekja e ecurisë së hetimit dhe problematikat e hasura, si

dhe i krijimit të marrëdhënieve me Oficerët e Policisë Gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë, e seksioneve dhe shërbimeve të Policisë, si dhe me institucione të tjera.

Gjatë periudhës që analizojmë, Drejtuesi i Prokurorisë ka ushtruar studimin e të gjitha materialeve kallëzuese dhe të referuara nga Policia Gjyqësore e ato me vendngjarje, duke marrë masa për shpërndarjen e tyre në hetim në mënyrë propocionale, ku hedhja e shortit bëhet manualisht, pasi është një prokuror i vetëm.

Urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm janë punuar dhe diskutuar në mbledhjet periodike, që zhvillohen çdo dy javë me stafin dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore për zbatimin e tyre.

## VII- INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

### 7.1. Masat e marra për zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë të gjitha masat e duhura për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme nr.12 datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”; udhëzimit nr.120 datë 08.09.2020 “Për miratimin e disa shtesave në rregulloren standarde të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”, miratuar me urdhërin nr.32/2017; udhëzimit nr.3 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, nga drejtuesi i prokurorisë për hedhjen e shortit elektronik në periudhën Janar-Dhjetor 2020, të cilat janë si më poshtë:

- Me udhëzimin e përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” jemi njohur në muajin korrik të vitit 2020, udhëzim i cili është punuar në mbledhjen e radhës, zhvilluar me datë 29.07.2020. Gjithashtu, jemi njohur dhe me ndryshimet e fundit të bëra me udhëzimin e përgjithshëm nr.16 datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020.....”.
- Përsa i përket nxjerrjes së ndonjë udhëzimi të përgjithshëm, për të lehtësuar zbatimin e tij, pra të udhëzimit nr.12 datë 20.07.2020, nga ana jonë nuk është nxjerrë një udhëzim, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka funksionuar me një prokuror të vetëm që nga muaji shtator 2019, ndaj nxjerrja e një udhëzimi të përgjithshëm është parë jo e domosdoshme, por në zbatim të nenit 20 të këtij udhëzimi është urdhëruar nga kryesekretaria që të merren masa për përgatitjen e regjistrit sipas modelit të dërguar bashkëlidhur dhe nga ana e kryesekretarisë ky regjister është realizuar, por nuk ka funksionuar, pasi siç dhe u përmend më lart për specifikën e të qenurit një prokuror i vetëm. Këtu theksojmë se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka një libër protokollit të qarkullimit të brendshëm të materialeve dhe akteve, i cili është mbajtur ndër vite dhe që ka vazhduar të mbahet.
- Drejtuesi i Prokurorisë, i cili është përgjegjës për krijimin e kushteve që bëjnë të mundur organizimin e punës, respektimin e ligjit e të etikës dhe mirëfunksionimin e prokurorisë, sipas parashikimeve të ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin

e prokurorisë....”, në mënyrë që të lehtësojë zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm ka nxjerrë urdhëra e udhëzime në zbatim të tyre, si dhe duke përpiluar e dërguar informacione në Prokurorinë e Përgjithshme në mënyrë periodike, duke raportuar mbi gjendjen e kriminalitetit, efikasitetin e ndjekjes penale, përpilimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e prokurorisë dhe jo vetëm.

Disa nga urdhërat e udhëzimet e nxjerra gjatë vitit 2020 po i rendisim si më poshtë:

- Udhëzimi nr.1 datë 10.03.2020 “Mbi masat administrative për mbarëvjtjen e punës në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga COVID-2019”.
  - Urdhër nr.3 datë 04.09.2020, dalë në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.10 datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave.....”.
  - Urdhëri nr.4 datë 11.09.2020, me nr.1461 Prot. datë 11.09.2020, “Për miratimin e rregullores standarde të .....”.
  - Udhëzimi nr.6 datë 23.10.2020 “Për procedurat e pranimit të nënpunësve të tjerë civilë të Prokurorisë Mat”.
  - Është përpiluar dhe dërguar informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020, informacion i dërguar me shkresën nr.109/1 Prot. datë 20.10.2020.
  - Është përpiluar dhe dërguar informacion mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, informacion i dërguar me shkresën nr.110/1 Prot. datë 19.10.2020.
  - Është përpiluar dhe dërguar informacion me objekt kryerjen e veprimeve procedurale për identifikimin e banesës së quajtur “Shtëpia e verdhë”....., informacion i dërguar me shkresën nr.133/1 Prot. datë 28.12.2020.
- Masat e marra për zbatimin e urdhërit Nr.120 datë 08.09.2020 “Për miratimin e disa shtesave në rregulloren standarde të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”, miratuar me urdhërin nr.32/2017 nga drejtuesi i prokurorisë.
- Në zbatim të Urdhërit nr. 120 datë 08.09.2020, nga ana e Drejtuesi të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat është nxjerrë urdhëri nr.4 datë 11.09.2020 me nr.1461 Prot. datë 11.09.2020, “Për miratimin e rregullores standarde të .....”, në pikat 2 dhe 3 të cilit urdhërohet të bëhen disa shtesa sipas aneksit 1, duke e përshtatur me shtesat në rregulloren standarde ekzistuese. Një kopje e kësaj rregulloreje me shtesat dhe ndryshimet e bëra e të miratuara dhe aktet e nxjerra në zbatim të saj i janë dërguar Prokurorisë së Përgjithshme, brenda afateve të kërkuara sipas urdhërimeve të pikës 2 të urdhërit.
  - Ndërsa, përsa u përket pikave “I” dhe “II” për zëvendësimin e drejtuesve të prokurorive me drejtues seksionesh dhe mbi gjendjen e seksioneve për vetë natyrën dhe specifikën që e karakterizon prokurorinë tonë, këto ndryshime janë të pasqyruara në rregullore dhe të miratuara, por momentalisht nuk gjejnë zbatim, pasi siç dhe u përmend më lart, kjo prokurori funksionon vetëm me një prokuror.



- Mbi masat e marra në zbatim të udhëzimit nr.3 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” nga drejtuesi i prokurorisë për hedhjen e shortit elektronik në periudhën Janar-Dhjetor 2020<sup>8</sup>.

### VIII- RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E PROKURORISË NË KUADËR TË ZBATIMIT TË KODIT TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR, TREGUESIT, ARRITJET DHE PROBLEMATIKAT

Një kujdes i veçantë i është kushtuar trajtimit të të miturve dhe grupeve të tjera vulnerabël në kërkimet alternative në Gjykatë. Në trajtimin e këtyre grupeve kemi respektuar parashikimet dhe rregullimet që bën ligji procedural penal.

- Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal për të Mitur, ndjekja e procedimeve penale me të mitur ka pësuar ndryshime të rëndësishme procedurale, si përsa i takon kompetencës për hetimin e këtyre procedimeve, ashtu edhe mënyres së trajtimit të viktimave dhe të pandehurve të mitur, të drejtat që duhet t’u respektohen, masat e sigurimit që aplikohen ndaj të miturve në konflikt me ligjin, procedurës së gjyqimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe dënimet ndaj tyre. Tani jemi në një situatë, e cila para së gjithash kërkon njohje të mirë të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, me qëllim që të mund të përshtasim koncepte dhe praktika të drejta dhe ligjore në ndjekjen e procedimeve me të mitur.
- Që nga viti 2019, në strukturën organike të Prokurorisë Mat është shtuar pozicioni i koordinatorit, i cili ka një rol të domosdoshëm në procesin penal.
- Në vitin 2020 ka këto tregues statistikor: Është regjistruar vetëm 1 procedim penal me autor një të mitur, procedim i cili është dërguar për gjykim në gjykatë dhe mbartet në gjykim për vitin 2021. I mituri në konflikt me ligjin është hetuar dhe dërguar për gjykim pa masë sigurimi personal, akuzuar për keyerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, e parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, gjithashtu nga viti 2019 është mbartur në hetim 1 procedim penal me 1 të mitur në konflikt me ligjin, çështje e cila është dërguar për gjykim në vitin 2020, ku në gjykimin dhe në dënimin e tij janë marrë në konsideratë dhe garancitë procedurale e ligjore të Kodit Penal për të Mitur. Po ashtu, nga viti 2019 janë mbartur në gjykim 3 çështje penale me 3 të mitur në konflikt me ligjin dhe dënimi i tyre ka qenë: në 1 rast është aplikuar institucioni i shmanges nga dënimi, duke e këshilluar për të vazhduar shkollën, 1 rast tjetër është dhënë dënimi me punë në interes publik, ndërsa 1 rast mbartet ende në gjykim për në vitin 2021.
- Janë kryer hetime të shpejta dhe janë respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale, si në drejtim të të miturve në konflikt me ligjin, të miturve dëshmitarë dhe viktimat të veprave penale. Për të gjitha rastet, nga ana jonë, pyetja e të miturve në konflikt me ligjin është bërë në prani të avokatit dhe të psikologut, po kështu është vepruar dhe me të mitur dëshmitarë dhe viktimat të veprës penale, që kërkon detyrimisht praninë e koordinatorit.
- Mbi aplikimin e dënimeve alternative, në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet me të mitur, ky lloj dënimi është patur në konsideratë, ku gjatë procesit të gjyqimit dhe gjykata ka vendosur për një rast me masë këshillimi dhe vazhdimin e studimeve, pasi autori ishte i mitur, në një rast ka aplikuar

<sup>8</sup> Për periudhën Janar-Dhjetor 2020 edhe ky udhëzim nuk ka gjetur zbatim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, pasi siç e kemi përmendur edhe më sipër kjo prokurori ka një prokuror të vetëm dhe çështjet kalojnë automatikisht tek ky prokuror, pra bëhet shpërndarja manuale.

dënimin me 100 orë pune në interes publik dhe në 1 rast tjetër dënimin me burg, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e dënimit.

- Në vitin 2020 është regjistruar vetëm 1 rast për veprën penale “Trafikim i të miturve” e parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, procedim i cili ka ardhur për kompetencë.
- Nuk kemi patur të regjistruar asnjë procedim penal për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese apo të keqtrajtimit/abuzimit të fëmijëve.
- Janë përmirësuar dukshëm aftësitë profesionale të Oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e çështjeve, që lidhen me drejtësinë penale për të mitur, duke i këshilluar për kryerjen e veprimeve, duke ju vënë në dispozicion për njohjen dhe zbatimin me përpikmëri të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, hyrë në fuqi me 1 Janar 2018 e Ligjit 37/2017, të strategjisë së drejtësisë dhe planit të veprimit 2020 për këtë kategori.

#### **IX- DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME**

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur, në analizë të tyre duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punës dhe veprimitarisë për vitin 2021 në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

##### **Ndër drejtimit e kryesore të punës duhen vlerësuar:**

**Së pari**, një ndër drejtimit kryesore të veprimitarisë së punës për vitin 2021 është rritja e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritja e cilësisë së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve penale. Cilësia në veprime pasqyron së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe Oficeri të Policisë Gjyqësore, duke e pasqyruar atë në përpilimin e akteve, formulimin dhe arsyetimin ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare, si dhe përfaqësimit në Gjykatë.

**Së dyti**, duhet rritur ndjeshëm kontrolli në dinamikë nga ana e Prokurorëve gjatë hetimeve paraprake të çështjeve, duke mos u mjaftuar me nxjerrjen e një urdhëri për kryerje veprimesh hetimore, priten deri në ardhjen e akteve nga shërbimet dhe Seksionet e Policisë Gjyqësore, duke shkaktuar vonesa në hetim, humbjen e aktualitetit të një veprimi hetimor që mund të rezultojë gjatë dinamikës, etj. Në dinamikë, gjatë kontrollit të veprimitarisë hetimore nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, Prokurori duhet të jetë jo vetëm një orientues i veprimeve hetimore apo të nxjerrë akte proceduriale për veprime specifike si kontrole, përgjime, etj., por duhet të jetë dhe iniciues apo nxitës për një hetim sa më dinamik, të shpejtë, të një hetimi të zgjeruar për të gjitha problematikat. Duhet të evidentojë konkretisht dhe përcjellë me informacione Drejtuesit e Prokurorisë problematika të veçanta, pengesa të ndryshme qoftë që kanë të bëjnë edhe me mënyrën e funksionimit të organizimit të punës së veprimitarisë hetimore, siç janë zvarritjet e pajustificueshme etj.

**Së treti**, për çështje të veçanta, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore, apo përhapjes së një krimi, duke ju referuar tendencës së kriminalitetit, aq më tepër për çështje të rënda dhe sensitive duhet bërë vlerësimi i diferencuar, duhet kryer analiza e vlerësimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lënë detyra konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore.

Marrja kontakt që nga momentet e para nga prokurori me të dyshuarin (arrestuarin / hetuarin / pandehurin) krijon një perceptim më të drejtë në lidhje me hetimet që do të kryhen më pas, shmang dhe probleme procedurale në lidhje me zgjedhjen e masës shtrënguese të marrë nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, si dhe për krijimin e një politike të drejtë të kërkesës për masë sigurimi, bazuar dhe në personalitetin e të dyshuarit etj.

### **Në prioritetet për vitin 2021 në vazhdim:**

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur, në analizë të tyre duhet të evidentojmë dhe drejtimet kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin 2021 në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

Për të përmirësuar më tej performancën në të gjithë treguesit e saj, do të fokusohemi në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritjen e profesionalizmit të Prokurorëve dhe të Oficerëve të Policisë Gjyqësore, fuqizimin e pavarësisë së institucionit, si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese.

### **SË PARI: Në luftën kundër korrupsionit!**

Evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara apo evidentuara kryesisht që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore apo private. Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicie për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndihet një shqetësim i përgjithshëm i komunitetit.

### **SË DYTI: Në luftën krimit të organizuar në veçanti dhe ulja e nivelit të kriminalitetit në përgjithësi!**

Kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, por edhe me faktorë të tjerë, ku duhen përmendur veprat penale kundër autoritetit të shtetit dhe korrupsionit, sidomos ato vepra penale që kanë impakt negativ në komunitet si “Kultivimi i bimëve narkotike”, duke e minimizuar apo zeruar, duke rritur rastet e hetimeve proaktive dhe veprimeve simuluese. Gjithashtu, duhet punuar më tepër nga oficerët e policisë gjyqësore për zbulueshmërinë e veprave penale, sidomos atyre në sferën ekonomike pasi zbulueshmëria për këtë vepër penale është në nivelin minimal.

### **SË TRETË: Trajnimi i Oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe rritja e aksesimit në Sistemin CAMS, aksesimi në databazat shtetërore!**

Duke rritur vëmendjen dhe profesionalizmin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në përdorimin e këtyre sistemeve.

Analizës i bashkëlidhen edhe tabelat përkatëse me treguesit statistikorë 2 vjeçarë.



**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ABAZ MUÇA**

**Për Prokurorinë Mat, ngarkesa e punës për prokurorin Abaz Muça.**

<b>PROKURORI</b>	<b>Çështje gjithsej</b>	<b>Dërguar gjyqit</b>	<b>Pushuar</b>	<b>Pezulluar</b>	<b>Mosfilluar</b>	<b>Totali përfunduar</b>	<b>Mbartur në hetim</b>
Abaz Muça	213+101= 314	54	94	42	101	299	15

**SHËNIM:**

Për sa sipër, prokurori Abaz Muça, për periudhën raportuese veç sa sipër, ka mbuluar edhe detyrën e prokurorit të ekzekutimeve të vendimeve penale gjyqësore, si dhe ka përfaqësuar organin e akuzës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat në gjykimin e kërkesave të të dënuarve pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel, për lirimin me kusht sipas nenit 64 e 59 të Kodit Penal e konkretisht:

Pjesëmarrja në gjykim për lirim me kusht në 23 raste, 19 prej të cilave të përfunduara, duke u vendosur për 3 raste pranimi i kërkesave të të dënuarve për lirim me kusht, nga ana e Gjykatës Mat dhe nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Pjesëmarrja në gjykim e çështjeve të veçanta penale si përlllogaritje burgimi ka qenë në 4 raste, përfitim nga L.A në 3 raste, kërkesa për mbikqyrje të veçantë në 3 raste, bashkime dënimesh në 5 raste, kërkesa për lejim përgjimi, zgjatje afati lejim përgjimi janë 48 kërkesa të bëra nga prokurori, deklarim ikjeje 8 kërkesa, qëndrim në shtëpi në 1 rast, ankim kundra vendimeve të prokurorit ka marrë pjesë në 9 raste, revokime vendim pezullimi në 6 raste, caktim mase mjekësore dhe rivlerësim mase mjekësore në 3 raste.